



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

## **MEMORANDUM SHPJEGUES**

### **PËR**

## **PROJET RREGULLORE NR. X/2023 PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E DOSJES ELEKTRONIKE TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE**

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo projekt – rregullore përcakton mënyrën e përdorimit, të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe qasjen në Sistemin e Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore.

Në veçanti, draft rregullorja përcakton mënyrën e krijimit, përditësimit dhe administrimit të dosjes elektronike të administratës gjyqësore me qëllim të menaxhimit të saj, duke filluar nga procesi i themelimit, vlerësimit të rezultateve në punë si dhe ndryshimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës.

	<p>Po ashtu, rregullorja përcakton qasjen në dosjen elektronike sipas profileve të përdoruesve si dhe regjistrimin dhe përditësimin e informacionit në sistem me saktësi dhe në kohë reale, duke siguruar integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave në sistem.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Arsyeja e hartimit të projekt Rregullores X/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore është jetësimi i planeve strategjike dhe planeve të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për krijimin e Sistemit Elektronik të Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore.</p> <p>Përmes hartimit të kësaj projekt rregullore synohet të rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse funksionimi i Sistemit të Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore si një mjet modern dhe efikas i administrimit të burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor.</p> <p>Rregullorja po ashtu synon të siguroj ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë të përcaktuar me ligj ku të gjithë përdoruesit e sistemit duhet ta ruajnë konfidencialitetin e informacionit zyrtar.</p>

	<p>Rregullorja po ashtu përcakton modulën e themelimit dhe ndryshimit të marrëdhënies së punës në administratën gjyqësore, duke përfshirë gjithashtu edhe modulën e vijueshmërisë dhe pushimeve, vlerësimit të rezultateve në punë, disiplinën, transferimin, pezullimin si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës.</p> <p>Hartimi i kësaj rregullore është i rëndësishëm për disa arsye:</p> <p>Së pari, krijimi i një sistemi elektronik për dosjet elektronike të administratës gjyqësore është në përputhje me standardet ndërkombëtare për infrastrukturën dixhitale në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Së dyti, ky sistem elektronik i centralizuar rrit efikasitetin administrativ dhe menaxherial në procesin e administrimit të të dhënave të administratës.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Projekt Rregullore nr. X/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo</p>

	<p>sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p><b>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 5 dhjetor 2023.</b></p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft të udhëzimit administrativ, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: <a href="mailto:kgjk@rks-gov.net">kgjk@rks-gov.net</a></p>